

25.01.2023  
Ora 13:45

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale nga vendet e numërimit të votave në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |           |                     |
|------------|-----------|---------------------|
| • Ilirjana | NANO      | Kryetar             |
| • Arens    | ÇELA      | Anëtar              |
| • Dritan   | ÇAKA      | Anëtar              |
| • Helga    | VUKAJ     | Anëtar              |
| • Muharrem | ÇAKAJ     | Anëtar              |
| • Stafi    | KQZ       | Y. Merkaaj, M. Koja |
| Parti      | Politike: | S’ka prezent        |
| Të         | tjerë:    | KRIIK               |

*Znj. I. Nano:* Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 13.00. Fillojmë pak me vonesë për shkak se kishte dhe mbledhje më herët të Komisionerit dhe të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Në mbledhjen e Komisionit Rregullator janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi projektvendimin “Për rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

vendet e numërimit të votave dhe transmetimi në kohë reale nga vendet e numerimit të votave në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”. Para se të fillojmë mbledhjen duke deklaruar praninë e plotë të antarëve do doja të pyesja nëse ka ndonjë çështje jashtë rendit të ditës. Kolegë, keni diçka për të diskutuar jashtë rendit të ditës? Nëse jo, fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit që kemi në rendin e ditës. Ky projektvendim vjen në Komisionin Rregullator me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zoti Merkaj ju lutem nje përmbledhje të shkurtër të projektaktit dhe relacionit shpjegues, faleminderit!

**Z. Y. Merkaj:** Bazuar në nenin 20, shkronja 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, nenin 22, 23 dhe 94 të Kodit Zgjedhor. Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për mbulimin e aspekteve apo procedurave të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi. Në vitin 2021 Komisioni Rregullator miratoi rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve në vendet e numërimit të votave në kohë reale në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Projektvendimi që propozohet përcakton të njëjtat procedura dhe rregulla të miratuara më parë nga ky komision për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin e imazheve në kohë reale nga vendet e numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky projektvendim është i natyrës normative dhe për këtë arsye propozohet që procedurat të jenë të aplikueshme për të gjithë proceset zgjedhore. Risia e projektvendimit të propozuar është si vijon: Mënyra e ruajtjes së materialit filmik (video) nga kamerat e tavolinave dhe kamerat e vrojtimit administrohet dhe ruhet në serverat e KQZ-së. Regjistrimi filmik (video) ruhet në dosje të veçanta të

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

emërtuara sipas numrit të KZAZ-ve ku është bërë regjistrimi. Brenda çdo dosje të KZAZ-së, pamjet filmike ruhen të ndara në dosje sipas kategorisë së kamerës: Regjistrimi filmik i tavolinave të numërimit për çdo tavolinë të ruajtur veçmas, dhe Regjistrimi filmik i kamerës së vrojtimit. Projektvendimi parashikon që regjistrimi filmik (video) i procesit të numërimit të votave nga kamerat e vrojtimit në VNV, të cilat përmbajnë të dhëna personale i vihen në dispozicion vetëm organeve ligjzbatuese me kërkesë të tyre. Ky parashikim vjen në zbatim të legjislacionit të posaçëm për ruajtjen e të dhënave personale. Pas dorëzimit në KQZ, regjistrimi filmik i procesit të numërimit të votave nga kamerat e tavolinave dhe kamerat e vrojtimit në VNV, ruhet në përputhje me rregullat teknike të përcaktuara në ligjin “Për Arkivat” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për një periudhë 10 vjeçare nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Pas kalimit të këtij afati regjistrimet filmike trajtohen sipas udhëzimeve teknike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Periudha 10 vjeçare e ruajtjes është përlllogaritur duke iu referuar afateve të parashkrimit të veprave penale. Masa maksimale e dënimit për veprat penale në fushën e zgjedhjeve është 8 vite burgim. Për këtë arsye, sugjerohet që ruajtja e materialit filmik të procesit të numërimit të votave nga kamerat e tavolinave dhe kamerat e vrojtimit në VNV të ruhet në përputhje me rregullat teknike të legjislacionit në fuqi për arkivat për periudhën 10 vite pasi kjo është periudha e cila përmbush qëllimin e mbledhjes së këtij informacioni. Bashkëlidhur kemi edhe projektvendimin për shqyrtim si edhe shtojcën që I bashkëlidhet këtij vendimi. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj, ditën e sotme neve si Komision Rregullator na është vënë në dispozicion edhe një shkresë e një organizate të Shoqërisë Civile konkretisht organizata KRIIK me një rekomandim përkatës të cilin do ta shqyrtojmë në momentin që do të vimë te neni për të cilin na është bërë rekomandimi. Fillojmë njëherë me diskutimin dhe votimin në parim të

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

projektvendimit pastaj kalojmë nen për nen. Kolegë lidhur me projektvendimin në parim! Padyshim dhe unë pa rënë në përsëritje do doja të theksoja rëndësinë e disa risive të prezantuara në këtë projektvendim që lidhen me ruajtjen e materialeve filmike duke patur parasysh pikërisht afatet e dënimit të krimeve zgjedhore dhe afatin e parashkrimit të ndjekjes penale për këto vepra penale dhe duke përputhur afatin e ruajtjes pikërisht me afatin e parashkrimit. Kalojmë në votim në parim kolegë,

***Kush është dakord me projektvendimin?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro, miratohet!

Fillojmë atëhere shqyrtimin dhe miratimin nen për nen ose pikë për pikë të projektvendimit.

Komisioni Rregullator vendosi:

Miratimin e rregullave procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave (VNV) dhe transmetimin e imazheve në kohë reale nga vendet e numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kështu që duhet të kalojmë te lidhja numër 1 për të parë rregullat. Po i lexoj një për një për të vlerësuar mundësinë e ndonjë shtese apo ndonjë ndryshimi në projektaktin e ardhur nga administrata. Atëherë te rregullat procedurale fillojmë:

1. Në çdo tavolinë numërimi në VNV, të instalohet një kamera në mënyrë të tillë që të realizojë regjistrimin video, për vlerësimin e çdo flete votimi. Të kaloj me leximin e të tjerave keni diçka këtu dhe pastaj do ta votojmë në tërësi pikën 1 dhe lidhjen 1?

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

Parametrat teknikë minimalë, për kamerën të jenë: Rezolucioni jo më i vogël se 3 Mega Pixel. Shpejtësia e regjistrimit video jo më e vogël se 25 frames për sekondë, në rezolucionin e kërkuar.

Keni diçka kolegë? Po zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit kryetare! Nisur nga fakti që parametrat teknikë minimalë besoj janë vendosur që në aktet e mëparshme unë do të sygjeroja që për t'i dhënë mundësi dhe administratës së KQZ-së që të sigurojë kamera regjistrimi me një rezolucion të lartë mos të vendosim limite qoftë dysHEME, qoftë tavan lidhur me karakteristikat teknike të kamerave por të bëjmë një formulim në parim duke i qëndruar dhe natyrës së akteve të cilat miraton Komisioni Rregullator. Më konkretisht, unë propozoj që pika 2 të riformulohet, kamerat e regjistrimit të jenë të një rezolucioni të lartë dhe shpejtësia e regjistrimit video të jetë në përputhje me rezolucionin e kërkuar, pra ti heqim parametrat teknikë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Dhe unë kolegë i bashkohem mendimit tuaj sepse përndryshe pastaj Komisioni Rregullator do të shndërrohet në njësi prokurimi kështu që në vendosim disa karakteristika teknike dhe detajimet do të duhet t'i bëjë administrata e KQZ-së gjatë procesit të prokurimit të këtij shërbimi. Meqënëse kemi këtu zyrtarë të KQZ-së dhe të njërive teknike, do doja të kërkoja dhe mendimin e tyre nëse ky propozim i zotit Çakaj është lehtësues, është pengues për ju apo është në përputhje, po zonja Alimemeti.

**Znj. D. Alimemeti:** Mendoj që është në përputhje me çfarë kërkohet le të themi do të thotë procesi i punës është njësoj për ne, sepse ne do të vendosim specifikime teknike në lidhje me procedurën e prokurimit që do të ndajmë dhe do të specifikojmë le të themi elementët teknikë. Kjo besoj se është e mjaftueshme duke vendosur këtë specifik në lidhjen numër 1. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

**Znj. I. Nano:** Faleminderit kolegë! Kemi ndonjë diskutim për propozimin e zotit Çakaj, t'a kalojmë për votim këtë propozim të pikës 2, dhe më pas e votojmë gjithë lidhjen në tërësi nëse do të kemi ndryshime të tjera?

**Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj për riformulimin e pikës 2?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në pikën 3. Kamera të transmetojë në kohë reale procesin e numërimit të votave në një monitor (ekran), të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Kemi diçka për këtë? Jo?

Pika 4. Madhësia e ekranit jo më e vogël të jetë ndoshta, jo më e vogël se 32 inch. Imazhi i transmetuar në ekran duhet të zërë gjithë hapësirën e ekranit pa konture apo hapësirë boshe. Imazhi i fletës së votimit në ekran, të zërë jo më pak së 80% të ekranit. Në fakt edhe këtu kemi disa specifikime teknike megjithatë kemi një kufi minimal lidhur me madhësinë e ekranit, nuk e di nëse ka ndonjë kolegë ndonjë koment apo propozim për ndryshim?

**Znj. H. Vukaj:** Një pyetje për ekspertët e administratës në kuadër të risive teknologjike, a do të ishte ky një parametër tavan, më falni dysHEME në kushtet kur kemi këtë evolucion kaq dinamik të pajisjeve elektronike apo ka ndryshuar rethanat dhe mund të na sillni ju një evidencë që i përshtatet.

**Znj. D. Alimemeti:** Në eksperiencën që kemi nga dy vitet e mëparshme mendoj që ky është informacion ose informacion le të themi madhësia e ekranit dhe kjo 80% e fletës së votimit e vendosur, e regjistruar le të themi, përmbush qëllimin se mund të kërkojnë ose mund të vendosim elementë të tjerë po do të kemi problematika, problematika do të ndikoj në kosto dhe kjo është pjesa e asaj që

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

mund të them që duke qënë brënda qëllimit them se nuk ka arsye për të ndryshuar këtë element.

**Znj. I. Nano:** Pra imazhet e transmetuara në këto kamera janë të qarta janë të.

**Z. Y. Merkaj:** Kanë subjektet zgjedhore si vëzhguesit nga tavolina e numerimit të votave mendohet që 32 inch është madhësia optimale.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Atëherë për këtë pikë nuk kishim propozime.

Kalojmë në pikën 5. Të gjitha imazhet e marra nga kamerat, duhet të regjistrohen në formë digjitale gjatë gjithë procesit të numërimit të votave. Ka diçka të kalojmë më tej? Kolegë nëse keni diçka më ndërprisni për pikën konkrete.

Pika 6. Regjistrimi duhet të kryhet me rezolucionin e transmetimit të imazhit në ekran dhe duhet të krijojë mundësi për kontrollin dhe pamjen e mëvonshme të të gjitha regjistrimeve të kryera. Pajisjet e regjistrimit duhet të kryejnë regjistrim të dyfishtë, të njëkohshëm në 2 njësi të brendshme të pavarura (Mirror). Në çdo imazh të transmetuar dhe të regjistruar të jenë të evidentuar numri i tavolinës në të cilën po numërohen votat dhe numri i grupit të numërimit. Të evidentohet qartë në transmetim dhe regjistrim momenti i fillimit dhe përfundimit të procesit të numërimit të fletëve të votimit për çdo qendër votimi, si dhe të evidentohet qartësisht numri i qendrës së votimit.

Pika 9. Në çdo VNV të instalohet një kamera vërtetimi 360°, që të mbulojë të gjithë hapësirën e sallës në VNV. Kamera gjatë gjithë kohës duhet të regjistrojë të gjithë hapësirën pavarësisht nga orientimi i kërkuar në momente të caktuara dhe të mundësojë regjistrimin video dhe audio të sallës.

Pika 10. Kamera e vërtetimit dhe kamerat e tavolinave, gjatë procesit të numërimit duhet të transmetojnë imazhet pranë zyrave qendrore të KQZ-së, në çdo kohë kur

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

paraqitet ndonjë problematikë, ose kur kërkohet nga KQZ me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Znj. H. Vukaj:** Mund të ndërhyj?

**Znj. I. Nano:** Po zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Parë ne kontekstin e përgjithshëm ky udhëzim apo kjo shtojcë duket sikur te pika 10, bie ndesh me pikat pararendëse se të krijon përshtypjen sikur heq mundësinë e marrjes së informacionit në kohë reale ose në cdo kohë duke e kushtëzuar me pjesën e dytë të fjalisë dhe unë do të kisha një propozim më shterues dhe që përputhet me tërësinë e qëllimit të kësaj shtojce. Kamerat e vrojtimit dhe kamerat e tavolinave gjatë procesit të numërimit duhet të transmetojnë imazhet pranë zyrave qendrore KQZ në çdo kohë pra, pjesa ‘kur paraqitet ndonjë problematikë që e kushtëzon dhe e bën të dyshimtë marrjen e informacionit ose duket sikur e fut në jo vetëm në papërputhshmeri me çfarë thuhet ose parashikohet në tërësinë e këtij akti por e fut në dilemën që shiko unë se kam mundësinë që të marr dhe të transmetoj imazhet në të gjitha rastet apo në çdo kohë. Prandaj unë mendoj që fjalia duhet të shterohet mbas fjalës “në çdo kohë”.

**Znj. I. Nano:** Atëherë pyesim kolegët për mundësitë teknike të paktën në dijeninë tonë dhe në zgjedhjet e kaluara, mundësia teknike e transmetimit në kohë reale egziston nga çdo KZAZ pranë KQZ-së. Kolegë ndonjë propozim tjetër, apo diskutim lidhur me këtë çështje? Nga administrata ka ndonjë diskutim?

Atëherë votojmë propozimin e zonjës Vukaj. Pra të riformulohet pika 10 me këtë përmbajtje “Kamera e vrojtimit dhe kamerat e tavolinave, gjatë procesit të

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

numërimit duhet të transmetojnë imazhet pranë zyrave qendrore të KQZ-së, në çdo kohë”.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

***Kundra:*** S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 11. Transmetimi i imazheve të bëhet në rrjet të mbyllur, të pavarur dhe me kapacitet të nevojshëm qarkullimi online.

Pika12. Në ambientet e KQZ-së duhet të krijohen mundësi.

***Znj. H. Vukaj:*** Më fal e nderuar aty te pika 11 nëse mund ti kthehemi.

***Znj. I. Nano:*** Po

***Znj. H. Vukaj:*** Për ta riformuluar ose për të treguar më shumë në vëmendje ndaj përshkrimit që ka bërë, sepse duket sikur bie ndesh transmetimi i imazheve të bëhet në rrjet të mbyllur, të pavarur dhe me kapacitet të nevojshëm qarkullimi online. Duke thënë qarkullimi online duket sikur humbasim rëndësinë apo kushtëzimin kryesor pra në një rrjet të mbyllur e cila është garancia më e madhe. Atëherë nëqoftëse nuk bie ndesh duhet riformuluar fjalia. Transmetimi i imazheve të bëhet në rrjet të mbyllur. Pikë. Pastaj të pavarur dhe me kapacitet të nevojshëm qarkullimi online mund të jetë kushtëzues vetëm në rastin për KQZ-në. Pra kur KQZ-ja bëhet faktor pra subjekt kryesor i marrjes së këtyre të dhënave.

***Znj. I. Nano:*** Ne fakt mesa e kuptoj unë por ndoshta do kërkoj ndihmën e kolegëve, ideja është që transmetimi i imazheve bëhet fjalë KZAZ-KQZ. Ky është rrjet i mbyllur dhe KZAZ nuk transmeton kërkund tjetër përveçse në KQZ.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

Kapaciteti i nevojshëm pse është vendosur si karakteristikë këtu? Kapaciteti i nevojshëm i qarkullimit online çfarë nënkupton?

**Znj. D. Alimemeti:** Në vazhdim nëqoftëse shikoni është e lidhur dhe me pikën 12 ku flitet për një sasi tavolinash numërimi do të thotë që mund të transmetojë njëkohësisht kjo është ideja e transmetimit dhe kalimit të informacionit nga vendet e numërimit të votave në KQZ dhe do kemi një limit. Nuk mund t'i transmetojmë të gjitha vendet, nuk mund të behet transmetimi i 92 vendeve të numërimit të votave, por do të jetë ky limiti i 8 dhe ky limit lidhet pastaj dhe me pjesën e transmetimit të imazheve që themi që është në rrjet të mbyllur që do të thotë se informacioni është i sigurt kalon online do të thotë mënyra e kemi live do të thotë e vendosur në atë moment që transmetohet në KQZ, në kohë reale do të jetë e transmetuar dhe në KQZ.

**Znj. H. Vukaj:** Pra, lidhja mund të riformulohet për t'i dhënë siguri palëve të cilat do ndeshen me zbatimin e këtij akti dhe të cilat nuk do të kenë një mendje ndryshe për ta parë me prespektivën që edhe mund të sajojnë dicka 'online'. Kështu që unë i mbetem atij propozimi nëqoftëse kolegët kanë ndonjë propozim tjetër t'a diskutojmë?

**Znj. I. Nano:** Zoti Çaka ka dicka ndoshta konvergoni

**Z. D. Çaka:** Doja të bëja një pyetje,

**Znj. H. Vukaj:** Edhe një gjë që ndoshta më shkon për shtat të gjithëve kolegë do të doja të dija se bëhet fjalë për transmetin HD. Çfarë lloj transmetim imazhesh kemi?

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** Këtë pastaj do ta shohim në specifikimet që do të vendosim në dhe çfarë do të kemi në vijim në pjesën e prokurimit, por gjithsesi mbledhja e informacionit ose në ato çfarë unë kam parë nga 2021 dhe 2022 janë HD.

**Znj. H. Vukaj:** Do te thotë që cilësia e materialit filmik është HD, ju do të ruani të njëjtin standart?

**Znj. D. Alimemeti:** Po, po patjetër minimalisht. Por po rimarr pikën 11 mund të jetë një ndryshim transmetimi i imazheve të bëhet në rrjet të mbyllur, të pavarur dhe me kapacitet të nevojshëm transmetimi. Dhe mbyllet problematika e onliniit.

**Znj. I. Nano:** Me kapacitet të nevojshëm transmetimi. Zonja Vukaj dhe zoti Çaka se kishte dhe zoti Çaka diçka, po.

**Z. D. Çaka:** Atëherë doja të bëja një pyetje për përfaqësuesit e administrates. Kur flasim për këtë transmetim nëpërmjet kësaj pike ne kemi parasysh tre karakteristika pra që transmetimi të jetë i mbyllur pra në një rrjet të mbyllur, i pavarur dhe karakteristika tretë të jetë me kapacitet të nevojshëm qarkullimi online. Pra qarkullimi online lidhet vetëm me kapacitetin pra me karakteristikën e kapacitetit të këtij transmetimi?

**Znj. D. Alimemeti:** Për transmetimin në kohë reale do të thotë pra transmetimi që bëhet nga VNV-të në KQZ të jetë real ajo që ndodh të transmetohet automatikisht.

**Z. D. Çaka:** Pra në vazhden e kësaj duke menduar dhe merakun që ka dhe kolegja Vukaj nuk e di sesi të gjithë mund ta vlerësojmë këtë propozim. Trasmetimi i

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

imazheve të bëhet në rrjet të mbyllur, të pavarur si dhe të ketë kapacitet të nevojshëm qarkullimi online.

**Znj. I. Nano:** Ose trasmetimi

**Z. D. Çaka:** Ose transmetimi online.

**Znj. H. Vukaj:** Online tingëllon sikur ka dy moduse shfrytëzimi dhe duket sikur është pistë e hapur për...

**Znj. I. Nano:** Pra shqetësimin tonë e permbush propozimi i zonjës Alimehmeti pra transmetim kapacitet të nevojshëm transmetimi?

**Znj. D. Alimemeti:** Të shtojmë dhe transmetim në kohë reale mbase për ta ezauruar të tërë .

**Znj. I. Nano:** Dakord, në kohë reale aq më mirë e lidhur dhe me pikën e mësipërme që nënkupton transmetimin. Pra me kapacitet të nevojshëm transmetimi në kohë reale.

**Znj. H. Vukaj:** Vetëm kemi atë përsëritjen e fjalës transmetimi imazheve të bëhet në rrjet të mbyllur e të pavarur të jetë një fjali dhe pastaj mund të vijohet me kapacitet të nevojshëm transmetimi në kohë reale.

**Znj. I. Nano:** Atëherë votojmë kolegë për këtë ndryshim dhe riformulojnë administrata me gjithë shqetësimet që u paraqitën.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

**Kundra: S'ka**

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 12. Në ambientet e KQZ-së duhet të krijohen mundësi monitorimi të njëkohshëm, për të paktën 8 VNV dhe 8 tavolina numërimi. Procesi i regjistrimit dhe transmetimit në të gjitha VNV-të, duhet të ketë pavarësi nga energjia elektrike për së paku orë.

**Znj. H. Vukaj:** Një pyetje a egziston mundësia e ndryshimit të këtyre kapaciteteve në sensin e rritjes së këtyre kapaciteteve pra mund të pretendojmë sot në keto zgjedhje për një kapacitet të shtuar nga 8 në një numër më të lartë? Te pika 12 por dhe te 13 nëqoftëse ai minimum i dy orëve mund të ketë një rritje.

**Znj. D. Alimemeti:** Në pjesën e kemi përcaktuar buxhetet të cilat janë të referuara le të themi kontratave të mëpërparshme dhe duke patur parasysh këto vlera jemi pakëz në këto parametra.

**Znj. H. Vukaj:** Jeni të kondicionuar për arsye të buxhetimit?

**Znj. D. Alimemeti:** Për shkak të buxhetimit.

**Znj. I. Nano:** Atëherë duke mos patur më diskutime lidhur me 13 pikat e lidhjes numër 1 votojmë në tërësi lidhjen 1 me të gjitha ndryshimet e propozuara dhe të votuara. Kush është dakort? Zoti Çaka më fal, po ?

**Z. D. Çaka:** Atëherë duke pasur parasysh çfarë është diskutuar në përmbajtje të pikës 1 nuk ka të bejë vetëm me rregulla proceduriale por në thelb mund të themi që janë vendosur dhe disa karakteristika minimale mbase duhet të ndryshoj dhe tituli i lidhjes? Apo do ta lëmë kështu?

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

**Znj. I. Nano:** Në fakt ne sikur hoqëm dorë nga karakteristikat duke ja lënë administratës, pra ato që në thonjëza mund të quhen karakteristika janë disa parime të përgjithshme për të siguruar këtë lloj transmetimi. E votojmë lidhjen 1 me gjithë ndryshimet e bëra deri më tani?

**Kush është dakord kolegë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pra deri tani kemi miratuar pikën 1 të projektvendimit e cila është sipas lidhjet 1 bashkëlidhur.

Pika 2. Regjistrimi filmik (video) i procesit të numërimit të votave nga kamerat e tavolinave dhe kamerat e vrojtimit në VNV të ruhet në pajisje elektronike të sigurta dhe të dorëzohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve së bashku me materialet e tjera zgjedhore. Kemi ndonjë diskutim për pikën 2? Po zonja Vukaj?

**Znj. H. Vukaj:** Përsëri për administratën do doja të shuaj kureshtjen se çka parasysh administrata kjo njëkohësisht nuk bëhet për mua por dhe për publikun të marr garanci se çdo të thotë për të pajisje elektronike të sigurta sepse e kemi të përsëritur në dy pika të këtij projektvendimi dhe një qartësim nga ana juaj do t'i shërbente.

**Znj. D. Alimemeti:** Po patjetër.

**Znj. H. Vukaj:** Trasparencës.

**Znj. D. Alimemeti:** Ruhet regjistrimet filmike në fund të procesit kalohen le të themi ruhen në paisje të cilat dorëzohen në KQZ. Këto pajisje mund të jenë dhe hard disqe të jashtëm por që duhet të ruhen mund të jenë të ruajtura me password

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

le të themi të kenë kapacitetet e ruajtjes së informacionit brenda tyre mund të jenë paisje të enkriptuara por që nuk mendoj dhe sygjeroj që të shkojmë deri në pjesën e encriptimit se janë pamje filmike video, për të kaluar pastaj dhe për tu transmetuar në serverat e KQZ, do të thotë kalimi i informacionit nga mbledhja e tyre le të themi nga cdo VNV ne KQZ të bëhet me këto paisje që të kenë një nivel sigurie le të themi, mbrojtje ose ruajtje extra jo të hapura. Kjo është patur parasysh.

**Znj. H. Vukaj:** Pra ju e keni të qartë para prokurimit se çfarë sigurie kërkojnë këto paisje dhe ndërkohë penetrimi apo tendenca për tjetërsim të mos ekzistojë. Dakord. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Dakord! Kalojmë në votimin e pikës 2, kolegë

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 3. Administrata e KQZ-së, ose kur është e mundur edhe Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, riprodhon dhe vë në dispozicion të subjekteve zgjedhore, me kërkesë të tyre, kopje të materialit të regjistruar nga kamerat e tavolinave kundrejt pagesës së një tarife që mbulon koston e riprodhimit. Tarifa miratohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Kemi ndonjë diskutim për pikën 3? Nëse jo kalojmë në votimin e pikës 3.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në :

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

Pika 4. Regjistrimi filmik (video) i procesit të numërimit të votave nga kamerat e tavolinave dhe kamerat e vërtimit të ruhet në pajisje elektronike të sigurta dhe të dorëzohet në

Te dokumenti që kam unë kjo ishte 4

**Z.Y. Merkaç:** Pika 5 bëhet pika 4 sepse pikën 4 e kemi diskutuar njëherë.

**Znj. I. Nano:** Është përsëritur. Kalojmë te pika 5 e projektvendimit që është pika 4 bie. Dakord!

Pika 4. Regjistrimi filmik nga kamerat e tavolinave dhe kamerat e vërtimit administrohet dhe ruhet në serverat e KQZ-së. Regjistrimi filmik (video) ruhet në dosje të veçanta të emëtuara sipas numrit të KZAZ-së ku është bërë regjistrimi. Brenda çdo dosje të KZAZ-së pamjet filmike ruhen të ndara në dosje, në nëndosje besoj se duhet të jetë mendoj, nuk e di pra regjistrimi filmik ruhet e pra në file themi dosje nëndosje nuk ka? E lëmë dosje atëherë pra: Brenda çdo dosje të KZAZ-së, fashikuj, pamjet filmike ruhen të ndara në dosje, sipas kategorisë së kamerës:

- a) Regjistrimi filmik i tavolinave të numërimit për çdo tavolinë të ruajtur veçmas,
- b) Regjistrimi filmik i kamerës së vërtimit.

Kemi ndonjë diskutim lidhur me këtë nen? Nëse jo kalojmë në votimin e pikës 4.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Vijmë te:

Pika 5. Regjistrimi filmik (video) i procesit të numërimit të votave nga kamerat e vërtimit në VNV, të cilat përmbajnë të dhëna personale i vihen në dispozicion vetëm organeve ligjzbatuese me kërkesë të tyre.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

Sikundër ju thashë në fillim të mbledhjes lidhur me këtë pikë kemi pasur sot dhe kemi arritur të konsultohemi paraprakisht me disa rekomandime të organizatës KRIIK, rekomandime që konsistojnë në vënien në dispozicion të regjistrimit filmik të procesit të numerimit të votave nga kamerat e vrojtimit edhe subjekteve zgjedhore pra jo vetëm organeve ligjzbatuese. Kolegë ka dicka për të diskutuar mbasi jeni njohur të gjithë me rekomandimet e KRIIK-ut? Lidhur me këto? Po zoti Çaka?

**Z. D. Çaka:** Po mbasi jemi vënë në dijeni edhe për propozimet e KRIIK-ut, duke parë dhe propozimet e bëra dhe nga Komisioneri Shtetëror, unë do të kisha një propozim të ri ose një fungim të ri në lidhje me këtë pikë, nuk e di nëse dhe kolegët do të bien dakort. Propozimi im është: Regjistrimi filmik (video) i procesit të numërimit të votave nga kamerat e vrojtimit në VNV, vihen në dispozicion me kërkesë të tyre organeve ligjzbatuese dhe subjekteve zgjedhore bazuar në legjislacionin në fuqi. Kopja e materialit për subjektet zgjedhore vendoset kundrejt një pagese të një tarife që mbulon koston e riprodhimit e cila miratohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

**Znj. I. Nano:** Ndoshta kolegët nuk e ndoqën propozimin e zotit Çaka, pra!

**Znj. H. Vukaj:** Ju kërkoj ndjesë por ishim në diskutimin e retushimit të pikës ose mbivendosjen e pikës 4 me pikën 5 nuk kuptuam këtë pjesë. Pika 4 duket sikur është rregullim i përgjithshëm pra detyron që materiali i kamerat e tavolinave apo kamerat e vrojtimit të ruhet në pajisje elektronike të sigurta dhe të dorëzohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve së bashku me materialet e tjera zgjedhore.

**Znj. I. Nano:** Është përsëritje e pikës 2, ky ishte gabimi në draft, pra pikën...

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

**Znj. H. Vukaj:** Mendova se u tha që ishte mbivendosje me 5?

**Znj. I. Nano:** Me 2-shin është me 2-shin. Atëherë duke qenë që kolegët po diskutonin këtë çështje, nëse është e mundur zoti Çaka dhe njëherë propozimin tuaj për riformulimin e pikës 5 tani.

**Z. D. Çaka:** Atëherë pika 5 të riformulohet: Regjistrimi filmik (video) i procesit të numërimit të votave nga kamerat e vrojtimit në VNV, i vihet në dispozicion me kërkesë të tyre organeve ligjzbatuese dhe subjekteve zgjedhore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kopje e materialit të regjistrimit nga kamerat e vrojtimit subjekteve zgjedhore iu vihen kundrejt një pagese të një tarife që mbulon koston e riprodhimit e miratuar kjo nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Pra tarifa.

**Znj. I. Nano:** Për analogji.

**Z. D. Çaka:** Për analogji me pikën 3 të draftit, pra siç ishte dhe për pjesën e kamerave të tavolinave të votimit.

**Znj. I. Nano:** Komisioneri?

**Z. D. Çaka:** Komisioneri po.

**Znj. I. Nano:** Domethënë propozimi mesa kuptoj, propozimi i zotit Çaka konsiston në dy ndryshime të mundshme të këtij neni. E para vënien në dispozicion dhe subjekteve zgjedhore jo vetem agjensive ligjzbatuese, po në përputhje me legjislacionin në fuqi, me gjithë legjislacionin që rregullon këtë çështje jo vetëm Kodin Zgjedhor, dhe pagesën e një tarife për ta marr për ta vënë

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

në dispozicion që është për analogji vetëm për subjektet se organet ligjzbatuese s' do ti vënë tarifë e marrin.

**Z. M. Çakaj:** Pra në thelb e kemi marrë në konsideratë propozimin e KRIIK.

**Znj. I. Nano:** Dakort. Atëherë votojmë propozimin e zotit Caka për riformulimin e pikës 5.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 6. Pas dorëzimit në KQZ, regjistrimi filmik (video) i procesit të numërimit të votave nga kamerat e tavolinave dhe kamerat e vrojtimit në VNV, ruhet në përputhje me rregullat teknike të përcaktuara në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për një periudhë 10 vjeçare nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Pas kalimit të, këtij afati regjistrimet filmike trajtohen sipas udhëzimeve teknike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Pra, është ajo pikë që u diskutua dhe më herët nga Sekretari i Përgjithshëm afati 10 vjeçar i ruajtjes dhe padyshim ruajtja në përputhje me rregullat teknike të parashikuara në legjislacionin për arkivat. Kolegë nëse s'keni ndonjë diskutim,

**Kush është dakord me nenin në pikën 6?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Kush është dakord?**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.25.01.2023*

**Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 8. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Miratohet me 5 vota.

Pasi e kemi miratuar në parim dhe pikë për pikë projektvendimin nëse administrata nuk ka diçka tjetër për të na thënë apo diskutuar kalojmë në miratimin në tërësi të projektvendimit dhe njëherë kolegë,

**Kush është dakord me projektvendimin me të gjitha ndryshimet e miratuara deri tani?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Duke qenë se u miratua me 5 vota vendimi për rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve në vendet e numërimit të votave dhe transmetimit në kohë reale, nga vendet e numrimit të votave në ambjentet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe meqë nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Ditën e mirë!

**Vendimi nr. 1**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*

